


Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Dhjetor 2023

Tiranë, më 25 Janar 2024: Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2023 është 10.155.640, duke u rritur me 34,6 %, në krahasim me vitin 2022. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në vitin 2023 është 6.913.347, duke u rritur 17,5 %, krahasuar me vitin e mëparshëm (tab.1).

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, 2022- 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Dhjetor 2023, janë 1.362.511. Ky tregues rezulton me një rritje 41,1 %, krahasuar me Dhjetor 2022. Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Dhjetor 2023, janë 1.152.429, duke shënuar një rritje me 7,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Hyrjet e shtetasve

Në Dhjetor 2023, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 745.517. Ky numër është rritur me 29,9 %, krahasuar me Dhjetor 2022.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 616.994. Ky numër është rritur me 57,6 %, krahasuar me Dhjetor 2022.

Për publikim 25/01/2024

Fig. 2 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Dhjetor 2022- Dhjetor 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Daljet e shtetasve

Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Dhjetor 2023 janë 602.346. Krahasuar me Dhjetor 2022, ky tregues ka rënë me 5,1 %.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Dhjetor 2023 janë 550.083. Krahasuar me Dhjetor 2022, ky tregues është rritur me 26,3 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë vitit 2023, është 6.913.347, duke u rritur me 17,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab.1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023	Ndryshimi vjetor %	Janar - Dhjetor 2022	Janar - Dhjetor 2023	Ndryshimi vjetor %
Hyrje gjithsej	965.495	1.362.511	41,1	13.009.619	17.125.595	31,6
Shqiptarë	573.930	745.517	29,9	5.465.802	6.969.955	27,5
Të huaj	391.565	616.994	57,6	7.543.817	10.155.640	34,6
Dalje gjithsej	1.070.394	1.152.429	7,7	13.406.826	16.550.198	23,4
Shqiptarë	634.998	602.346	-5,1	5.882.007	6.913.347	17,5
Të huaj	435.396	550.083	26,3	7.524.819	9.636.851	28,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Në Dhjetor 2023 rajoni me numrin më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri është rajoni i Evropës me 571.348 shtetas pasuar nga Amerika dhe Azia Lindore /Paqësori, përkatësisht me 9.845 dhe 2.617 shtetas (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023	Janar – Dhjetor 2022	Janar – Dhjetor 2023
Gjithsej	391.565	616.994	7.543.817	10.155.640
I. Afrika	188	835	4.614	11.120
II. Amerika	7.728	9.845	177.419	240.925
III. Azia Lindore dhe Paqësori	1.869	2.617	26.840	66.689
IV. Lindja e Mesme	932	755	41.862	40.446
V. Azia e Jugut	1.115	1.305	10.908	15.324
VI. Evropa	378.941	571.348	6.921.733	9.727.538
- Evropa Qëndrore / Lindore	11.149	19.216	429.301	643.332
- Evropa Veriore	11.520	20.090	258.367	380.476
- Evropa Jugore	326.958	498.067	5.661.878	7.743.693
- Evropa Perëndimore	18.842	23.556	468.743	744.821
- Evropa Lindore / Mesdheut	10.472	10.419	103.444	215.216
VII. Rajone të paspecifikuara	792	30.289	360.441	53.598

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Ilogaritjet INSTAT

Në Dhjetor 2023, krahasuar me Dhjetor 2022, hyrjet e shtetasve të huaj shënojnë:

- rritje, për qëllime personale me 58,4 %;
- rritje, për qëllime pushime, vizitë tek të afërm etj. me 65,1%;
- rritje, për biznes dhe qëllime profesionale me 20,4 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023	Ndryshimi vjetor (%)	Janar - Dhjetor 2022	Janar - Dhjetor 2023	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje shtetas të huaj	391.565	616.994	57,6	7.543.817	10.155.640	34,6
I. Personale	383.136	606.847	58,4	7.437.477	10.030.612	34,9
1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.	351.408	580.311	65,1	7.067.487	9.543.452	35,0
2. Trajtime shëndetësorë	25	54	116,0	2.392	949	-60,3
3. Qëllime fetare	33	29	-12,1	495	417	-15,8
4. Udhëtarë transit	31.670	26.453	-16,5	367.103	485.794	32,3
II. Biznes dhe profesionale	8.429	10.147	20,4	106.340	125.028	17,6

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Ilogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë periudhës së referencës llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë periudhës së referencës llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.;
2. Trajtime shëndetësore;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf

Të dhënat mujore Janar – Dhjetor 2023 janë revizionuar.

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarohen shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.